



Home > Aktualitet > Lëvizte me armë me vete, arrestohet 35-vjeçari në Vlorë, pamje nga ndalimi i të...

AKTUALITET

Lëvizte me armë me vete, arrestohet 35-vjeçari në Vlorë, pamje nga ndalimi i të riut (VD)

Nga policia është arrestuar A. Xh., 35 vjeç, banues në Fier.



Foto nga arrestimi.

4 Tetor, 2019 11:53

Vlorë- Në prangat e policisë së Vlorës ka rënë një 35-vjeçar pasi qarkullonte me armë zjarri. Nga policia është arrestuar A. Xh., 35 vjeç, banues në Fier.

Njoftimi i policisë:

Finalizohet operacioni i koduar "Blic"

Qarkullonte me armë zjarri nëpër qytet, vihet në pranga 35-vjeçari.

Në vijim të punës intensive për kapjen e personave që qarkullojnë me armë zjarri pa leje, strukturat e Policisë së Vlorës në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative se një shtetas qarkullonte me armë zjarri nëpër qytet, menjëherë organizuan punën në grup dhe finalizuan me sukses operacionin e koduar "Blic".

Si rezultat i këtij operacioni, falë bashkëpunimit të ngushtë me qytetarët, u bë kapja e menjëhershme e tij në bulevardin "Ismail Qemali", Vlorë.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](#)

Gjatë kontrolli fizik 35-vjeçarit i sekuestrohet në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë dhe 4 fishekë.

Në vijim të veprimeve procedurale, Seksioni për Hetimin e Krimit arrestoi në flagrancë, për veprën penale "Armëmbajtja pa leje", shtetasin A. Xh., 35 vjeç, banues në Fier.

Materialet iu referuan Prokurorisë për veprime të mëtejshme.



Policia e Shtetit

- Follow

Share

J.V/Dosja.al



ETIKETA: #arrestohet 35 vjecari ne vlore #i riu levizte me arme

1

SHARES



Previous article

Zbulohet kërpudha vdekjeprurëse, që tkurr trurin e njeriut dhe organet në trup

Next article

**Negociatat/ Rama: Na bëjnë për budallenj?
Merkel është kampione, u referohet të vdekurve si unë**

Shto Koment